VENDIM
Nr.1135, datë 5.8.2008

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e bazë mujore për gradë (kolona 3 e lidhjes nr.1), është niveli i pagës së punonjësit të Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën, që ka fituar.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolonat 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 e 13 të lidhjes nr. 1), jepet sipas funksioneve, të përcaktuara në këtë lidhje.

4. Punonjësi i Policisë së Shtetit, për kohën e qëndrimit në gradë, përfiton shtesë për vjetësi në punë, në masën 1 për qind, pas çdo viti pune. Masa e shtesës për vjetërsi në punë të jetë deri në nivelin e pagës bazë, të gradës pasardhëse.

Përllogaritja e shtesës për vjetësi në punë të fillojë në çastin e marrjes së gradës, sipas ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit".

5. Specialistët, përgjegjësit e sektorit apo drejtorët, në Policinë e Shtetit, që punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së Policisë së Shtetit dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë, në degët "Inxhinieri elektronike" apo "Informatikë", përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtesë për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.

6. Vendimi nr.558, datë 16.8.2006 i Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit", i ndryshuar, nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për politikat e pagave, për vitin 2008.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja Nr.1

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

			Shtesa per natyrë të veçantë pune e shërbimi									
Niveli	**Grada**											
		Paga bazë për gradë	Në funksione organike për hetimin e krimeve. Oficerët e policisë gjyqësore. Kartotekë kërkimi. Policia shkencore. gjurmimi teknik. Njësi operative e vëzhgimi. Specialistë të policisë në zonë.	Në funksione të Forcës së Posaçme & Oficerë të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda	Në funksione të sigurisë publike. Policia rrugore. Qendra e Emergjencave e sallave operative. Ruajtja e siguria e objekteve.	Në funksione ndalim paraburgim i	Në funksione organike të Policisë kufitare & migracionit.	Në funksione operuese të Forcave speciale (Kom rep, Zv/k rep Shef Shtabi në RENEA. Reparti Helikopterëve Njësia Antieksploziv. Njësia e Negociatorëve & Njësia e Lëvizshme Teritoriale për Kufirin e Migracionin)	Në funksione operuese Forcat e ndërhyrjes së shpejtë (k.rep/N/rep, Zv.k/rep shef shtabi)	Drejtor e Zv/drejt i Policisë së Qarkut. Shef komisariati.Shef stacioni.Komandant i Rep të Sigurisë së Brendshme e Ceremonialit .	Në funksione të shërb mbështetëse & administrative në Policinë e Shtetit	Në funksione organike Drejtor & Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Drejtor I Policisë së Qarkut Tirane & Drejtoria e Forcave të Lëvizëshme Operacionale.
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Niveli zbatues	Neninspektor	32000	6500		5500	6500	5500	40000	7000		2000	
	Inspektor	34500	6500		5500	6500	5500	40000	7000		2000	
	Kryeinspektor	39000	6500		5500	6500	5500	40000	7000		2000	
Niveli i pare drejtues	Nenkomisar	48300	6500	18500	5500		5500	40000	7000	6000	2000	
	Komisar	54250	6500	19500	5500		5500	40000	7000	6000	2000	
	Kryekomisar	80900	6500	22000	5500		5500	40000	7000	6000	2000	15000
Niveli i mesëm drejtues	Drejtues	92400	6500		5500		5500	40000	7000	6000	2000	15000
	Drejtues i I-re	94000	6500		5500		5500	40000	7000	6000	2000	15000
Niveli i lartë drejtues	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm	105000										15000
	Drejtor i Përgjithshëm	115000										20000